



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/ TH9-6 Prot.

Tiranë 02 /12 / 2024

Nr. Dok. 202400989/6

Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Bashkisë Sarandë, për moskthim përgjigje.

Drejtuar: Bashkisë Sarandë
Z. Oltion Çaçi, Kryetar

Sarandë

Për dijeni: Z. Th.V

Sarandë

Të nderuar!

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, sikurse jeni në dijeni ka depozituar një ankesë ndaj Bashkisë Sarandë, z. **Th.V.** Në këtë ankesë ka parashtruar ndër të tjera se, ai është banues në rrugën “Zenel Gjoleka”, Sarandë. Sikurse rezulton nga certifikata e rregjistrimit të pronësisë, të lëshuar nga DVASHK-ja Sarandë, ai është pronar i një banese si dhe i një garazhi me sipërfaqe 28.06 m2.

Para pak kohësh një komshiu i tij ka bërë punime pa leje para garazhit të tij. Konkretisht ai ka bërë zgjatjen e një tubi shkarkimi ngjitur me portën e garazhit të ankuesit, gjë e cila e pengon ankuesin që të fus automjetin në garazhin e tij.

Pas kontakteve me këtë person dhe mosrënien dakord për spostimin apo moszgjatimin e këtij tubi, ankuesi i është drejtuar me ankesë Bashkisë Sarandë, pasi sipas tij nuk ka asnjë lloj leje nga autoritetet kompetente për kryerjen e punimeve për zgjatimin e këtij tubacioni. Por deri më sot nuk ka marrë asnjë lloj përgjigje lidhur me këtë problematikë të ngritur prej tij dhe nuk ka patur asnjë reagim nga ana juaj.

Sa më sipër, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të tij të ligjshme.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal ashtu edhe në atë substancial për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenet 13, 17, shkronja "a" dhe 18 shkronja "b", të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes¹.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*", si dhe nenit 19, shkronja "b", të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, ku parashikohet se: "*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*", në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, i jemi drejtuar me disa shkresa Bashkisë Sarandë, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Konkretisht, kemi dërguar shkresën e parë me nr. K3/ TH9-2 prot., datë 18.07.2024, "*Kërkesë për shpjegime*". Në kushtet kur Bashkia Sarandë, nuk iu përgjigj kërkesës së Avokatit të Popullit, i jemi ridrejtuar sërish me shkresat nr. K3/TH9-4 prot., datë 28.08.2024 dhe nr. K3/TH9-5 prot., datë 25.10.2024 "*Kërkesë e përsëritur për shpjegime*". Në zbatim të nenit 19 paragrafi 2, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme*", kemi kërkuar që informacioni i mësipërm të na vihet në dispozicion brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga marrja e kësaj shkrese. Por, ju bëjmë me dije se përsëri nuk është kthyer përgjigje, edhe pse ka kaluar afati i përcaktuar, si dhe çdo afat i arsyeshëm kohor.

Në rrethanat e parashtruara sa sipër, ju bëjmë me dije se kjo situatë përbën shkelje flagrante të ligjit "*Për Avokatin e Popullit*", si dhe të Kodit të Procedurave Administrative, duke mos zbatuar dhe cenuar rëndë parimin e respektimit të hierarkisë institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitutional. Mosdërgimi i përgjigjes së kërkuar ka sjellë si pasojë mostrajtimin e kësaj

¹ Neni 13 i Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Avokati i popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike*"

ankese brenda afatit ligjor dhe mungesën e korrektesës së institucionit tonë ndaj ankuesit. Ky qëndrim i mbajtur nga organi juaj ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme, si dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankuesit.

Ndërkohë kjo sjellje, cenon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe dëmton imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik. Mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të saj e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publikë, për bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion. Më konkretisht neni 63 parashikon se: *“1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. 2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. 3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike. 4. **Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”.***

Pra, parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyrues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime. Rëndësia e këtij parimi konstatohet edhe në instrumentet ligjore që Kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike apo funksionarët publikë. Neni 63, pikat 1, 2 dhe 3, të Kushtetutës parashikojnë instrumente të tilla ligjore, në dispozicion të Avokatit të Popullit, si raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet apo propozime për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve përgjegjës. Gjithashtu, edhe ligji nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikon të drejtën e institucionit tonë për marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre. Në mënyrë eksplicite kjo është sanksionuar në nenin 22 të këtij ligji në të cilin është parashikuar se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.*

Parimi i bashkëpunimit mes organeve të administratës publike është sanksionuar si në Kodin e Procedurës Administrative ashtu dhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”. Neni 3 i këtij të fundit parashikon se: *“Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efijencës dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë*

ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucionet e pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin”. Duhet theksuar se Avokati i Popullit është institucion kushtetues, i cili ka rol “kontrollues” mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t’u krijohen shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike, përveç gjykatave.

Legjislatori ka parashikuar si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, edhe lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në kapjen e problemeve, si dhe mungesën e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë. Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu, minon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata shtetërore, ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian, por edhe atë të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Megjithatë, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta, theksojmë se detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit gjatë hetimit administrativ, veçse një detyrim i karakterit administrativ, është një detyrim kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky organ publik. Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Po ashtu, sjellim në vëmendjen tuaj se bashkëpunimi dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit është identifikuar si një nga elementët matës për vlerësimin e ecurisë së shoqërisë në kapitullin 23, përgjatë negociatave me BE.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Gjithë sa përshkruam më lart, evidentohet lehtësisht neglizhenca apo mungesa e bashkëpunimit të institucionit që ju drejtoni, duke ju referuar këtu afatit dhe datës kur kemi kërkuar informacion, që i përket datës 18.07.2024, ndërkohë akoma nuk kemi një përgjigje prej jush (rreth 4 muaj).

Referuar problematikës së hasur, në respektim të afateve procedurale të kthimit të përgjigjes, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga ju në ushtrim të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave funksionale, **marrjen e masave disiplinore**, për mosveprim në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi, për punonjësit përgjegjës të ngarkuar për kthim të përgjigjes së kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1, të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*,

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e detyrimit ligjor, për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit.
- Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës të Bashkisë Sarandë, lidhur me mospërmbushjen e detyrimit ligjor, për t’i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.
- Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë si dhe masat disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

KOMISIONERE

ERINDA MELI

d.v